

UDHËZIM
Nr.12/2, datë 15.6.2011

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.12, DATË 18.5.2011 “PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.10 418, DATË 21.4.2011 “PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor””, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “b” të pikës 1 të sesionit II.1 “Falja e detyrimeve tatimore” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) Tarifat, kombëtare apo vendore, të cilat për nga natyra, mbledhja dhe administrimi i tyre, legjislacioni i ka njehsuar me taksat.”

2. Në sesionin II.3 “Deklarimi vullnetar i detyrimit tatimor”, në fund të pikës 1 shtohen fjalët:

“Në rast se kontrolli tatimor të tatimpaguesi ka filluar përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 dhe udhëzimit nr.12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”” dhe tatimpaguesit nuk i është dorëzuar raport kontrolli, atëherë tatimpaguesit i lihet afat 10 ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për të bërë vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij sesioni. Në rast se brenda këtij afati 10-ditor, tatimpaguesi nuk ka bërë vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore, atëherë kontrolli tatimor do të vazhdojë sipas ligjit të procedurave tatimore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode